



VENDIM

Nr. 5, Datë 19.01.2017

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMET NR. 140, DATË 22.11.2013,
DHE NR. 61, DATË 07.07.2014 ”MBI RREGULLAT PËR ALOKIMIN E
KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONEVE”**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 65 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funksionimit dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 19.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 07.07.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”,

Konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Transmetimit harton rregulloren për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit, e cila miratohet nga ERE në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
- OST sh.a me shkresën nr. 7166 Prot., datë 16.11.2016 ka dërguar në ERE propozimin për disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 07.07.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE :

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e disa ndryshimeve në vendimet nr. 140, datë 22.11.2013 dhe nr. 61, datë 07.07.2014 të Bordit të Komisionerëve të ERE, mbi “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkonjeksioneve”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet OST sh.a, MEI, dhe Autoriteti i Konkurrencës për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI